



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBETAR RREGULLATOR

VENDIM

Nr. 36, datë 06.09.2017

**PËR LICENCIMIN PËR HERË TË PARË TË
SH. A UJËSJELLËS KANALIZIME CËRRIK**

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të Ligjit Nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura" si dhe VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit Sh.a Ujësjetllës Kanalizime Cërrik me:
Drejtues Ligjor Ervis Calja
Drejtues Teknik Jona Belshi
2. Operatori Sh.a Ujësjetllës Kanalizime Cërrik autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:
Kategoria A, Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
Kategoria C, Për largimin e ujërave të ndotura.
3. Zona e shërbimit të këtij operatori është Bashkia Cërrik.
4. Kjo liçencë është e vlefshme për një periudhe 4 (katër) vjeçare.

K R Y E T A R I

Ndriçim SHANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM

Nr.59, datë 25.11.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR
NR. 36, DATË 06.09.2017, "PËR LICENCIMIN E SH.A UJËSJELLËS KANALIZIME
CËRRIK"

Në mbështetje të nenit 13, 14, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**Ligji nr. 8102**), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë" (**VKM nr. 958**), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (**Rregullore e licencimit**),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 25.11.2019 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e projekt vendimit "Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 36, datë 06.09.2017 "Për licencimin e sh.a Ujësjiellës Kanalizime Cërrik",

Vëren se:

1. Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Cërrik (**UK Cërrik**) me shkresën nr. 428 prot datë 19.11.2019 të Entit Rregullator të ujit (**ERRU**), ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (**ERRU**) dokumentacionin për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor të shoqëruar sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (**KKRR**) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Cërrik për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit.
3. KKRR ka licencuar shoqërinë UK Cërrik me vendimin nr. 36, datë 06.09.2017 "Për licencimin e sh.a Ujësjiellës Kanalizime Cërrik", me një afat 4 vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë

shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, si dhe largimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtuesi ligjor i shoqërisë UK Cërrik sh.a. z. Eneo Taçaj, ka mbaruar studimet e larta në Ekonomi dega “Ekonomia dhe e Drejta” si dhe master për “E Drejtë Civile”.
5. ERRU në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Cërrik sh.a të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, efiçencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Cërrik është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit të KKRR nr. 36, datë 06.09.2017 “Për licencimin e sh.a Ujësjiellës Kanalizime Cërrik” bëhen këto ndryshime:

“Drejtues Ligjor z. Eneo Taçaj”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Ndriçim SHANI